



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN, ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTEVE

Nr. 570 Prot.

Patos, më 26/02/2024



MIRATOHET
KRYETARI
Faton Duro

PROJEKTVENDIM
Nr 19, datë 26/02/2024
PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR
RISTRUKTURIMIN E KËSHILLIT VENDOR RINOR DHE MËNYRËS SË
ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË TIJ

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 10, pika 3, të ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”, VKM-së nr. 969, datë 02.12.2020 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë”, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak:

1. Miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.
2. Pjesë e projekt-vendimit është dhe Lidhja 1 me kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.
3. Pas miratimit të këtij projektvendimi, ngarkohet për zbatim Drejtoria e Integritimit Evropian, Arsimit, Kulturës dhe Sportit.

**Drejtoresha e Integritimit Evropian, Arsimit
Kulturës dhe Sporteve**

Elda Goxhaj

Përgjegjëse e Integritimit Evropian

Irisi Xhelaj

Përgjegjëse e Sektorit Juridik

Nurkë Hazizaj

Specialiste e Rinisë

Simela Shahinaj

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Shkëlqim Beqiraj

Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Onaza”, Patos



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN, ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTEVE

Nr. 570 / Prot.
1

Patos, më 26/02/2024

RELACION

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR
RISTRUKTURIMIN E KËSHILLIT VENDOR RINOR DHE MËNYRËS SË
ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË TIJ**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 10, pika 3, të ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”, VKM-në nr. 969, datë 02.12.2020 “Për përcaktimin e kritereve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë”, Bashkia Patos ka miratuar kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë” me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 8 datë 25.02.2022 “Për miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor të rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij”.

Pas shpalljes publike të Bashkisë Patos në datë 05.04.2022, me Urdhërin nr. 75, datë 27.04.2022 u ngrit komisioni për vlerësimin e aplikimeve dhe me Urdhërin nr. 75 datë 20.05.2022 “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë” u emëruan 9 anëtarë.


Këshilli Vendor Rinor i Bashkisë Patos ka funksionuar si një organ këshillimor pranë bashkisë Patos.

Referuar pikës 3, të VKM-së nr. 969, datë 02.12.2020 “Për përcaktimin e kritereve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë”, mandati i anëtarëve të KVR përfundon në muajin Maj 2024, ndaj për të arritur afatet e shpalljes së dëgjesave publike dhe thirrjes publike, i propozojmë Këshillit Bashkiak:

1. Miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.

2. Pjesë e projekt-vendimit është dhe Lidhja 1 me kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.
3. Pas miratimit të këtij projektvendimi, ngarkohet për zbatim Drejtoria e Integritit European, Arsimit, Kulturës dhe Sportit.

**Drejtore e Integritit European, Arsimit,
Kulturës dhe Sporteve**

Elda Goxhaj



**Përgjegjëse e Sektorit të Integritit Evropian
Irisi Xhelaj**




**Specialiste e Rinisë
Simela Shahinaj**




**Sekretari i Përgjithshëm
Shkëlqim Begiraj**





**KRYETARI
Fation Duro**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN, ARSIMIT, KULTURËS DHE
SPORTEVE**

Lidhja nr.1

Anëtarët duhet t'i përkasin moshës 15-29 vjeç, të cilët shprehin vullnetin dhe interesin për t'u bërë pjesë e Këshillit. Këta anëtarë zbriten nga detyra pas 3 mungesave të pajustificuara në takime. Gjithashtu, të gjitha anëtarët e KVR janë të lirë të mund të japin dorëheqjen nga detyra me shkrim pranë kryetarit. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nëpërmjet një procesi transparent dhe demokratik.

Anëtarët e KVR identifikohen dhe shprehin interesin në bazë të një thirrje interesi të hartuar e njoftuar nga kryetari në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e bashkisë apo në rrjetet sociale të institucionit.

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga kryetari i bashkisë duke u bazuar në kriterin e përvojës së mëparshme me organizatat jofitimprurëse dhe në projekte që lidhen me të rinjtë.

Përzgjedhja e kandidatëve si përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë, bëhet nga kryetari dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë anëtarë i një organizate rinore ose për të rinjtë;
- b) të mos jetë i dënuar;
- c) të ketë përvojë në projekte, nisma dhe veprimtari rinore dhe për të rinjtë;
- d) të mos ketë konflikt interesi për shkak të anagazhimit të KVR.
- e)

Kandidatët për KVR, përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë duhet të aplikojnë duke paraqitur dokumentet e mëposhtme:

- a) Kërkesë me shkrim për shprehjen e interesit;
- b) Jetëshkrim (CV);

- c) Fotokopje të dokumentave që mbështesin shënimet e jetëshkrimit;
- d) Vërtetim të gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarim të saj;
- e) Letër interesi/ motivimi;
- f) Vetëdeklarim lidhur me shmangien e konfliktit të interesit;
- g) Referenca nga të paktën dy bashkëpunëtorë të mëparshëm.

Kandidatët për KVR, përfaqësues nga të rinj aktiv nga njësitë administrative duhet të aplikojnë duke paraqitur dokumentat e mëposhtme:

- a) Kërkesë me shkrim për shprehjen e interesit;
- b) Jetëshkrim (CV);
- c) Fotokopje të dokumenteve që vërtetojnë jetëshkrimin;
- d) Vërtetimin e gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarim të saj;
- e) Letër interesi/ motivimi;
- f) Vetdeklarim i konfliktit të interesit.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë të gjitha dokumentacionin e kërkuar në vendin dhe orën e përcaktuar nga bashkia.